


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësia Org. Org. Jedini. Org. Unit:	CC Nr. Prof. Br. Prof. Prof. No.: 211-1
Nr. i Hëqjenës Projektronica No. pages:	Data Datum Date: 14.07.2020
Dalfixa PRISHTINË/A	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO ZYRA E Kryeministrit - UREDE PRIME MINISTRI - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prof. Br. Prof. Prof. No.: 215	Nr. Prof. Br. Prof. Prof. No.: 2326-9/10/2020
Data Datum Date: 14.07.2020	Data Datum Date: 14.07.2020
Prishtinë/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Financave**  
**Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance**  
**Departamenti i Buxhetit - Budzet Department - Budget Department**

DATE/A:	10.07.2020
REFERENC-Ë:	AKKVP
PËR/ZA/TO:	z. Besnike Mehmeti, Zyrtare e lartë ligjore, ZKM
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i përgjithshëm, MF
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinioni i vlerësimit të ndikimit buxhetor për projektligjin për plotësim ndryshimin e ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave Kosovare

Ëndërrara znj. Mehmeti,

Bazuar kërkesës së Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për vlerësimin e ndikimit buxhetor për projektligjin për plotësim ndryshimin e ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave (AKKVP), formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor të paraqitur nga ZKM-ja dhe obligimin nga neni 19 i Ligjit nr. 07/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Departamenti i Buxhetit të Kosovës paraqet si në vijim:

**I. ASPEKTET E PËRGJITHSHME**

Qëllimi i këtij projektligjit është plotësim ndryshimi i ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave për hartimin e legjisllacionit sipas standardëve evropiane që ndërlidhen me të drejtat pronësore dhe përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

**II. OPINIONI LIDHUR ME VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)**

Zyra e Kryeministrit si organ propozues, ka përgatitur formularin e vlerësimit të ndikimit buxhetor të këtij projektligji në të cilin vlerëson dhe planifikon, se ky projektligj nuk prodhon kosto shtese buxhetore në buxhetin e Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2023, kostoja për zbatim të këtij projektligji i shpërndare në kategori të shpenzimeve dhe vite është si vijon:

Kostoja për zbatim e projektligjit	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Totali
Paga dhe Shtesa	1,257,950	1,264,240	1,270,561	1,276,914	5,069,665
Mallra dhe Shërbime	1,136,285	740,364	641,090	641,090	3,158,829
Shpenzime Komunale	88,523	88,523	88,523	88,523	354,092
Shpenzime Kapitale	431,500	331,500	431,500	431,500	1,626,000
<b>Totali</b>	<b>2,914,258</b>	<b>2,424,627</b>	<b>2,431,674</b>	<b>2,438,027</b>	<b>10,208,586</b>

Disa nga aktivitetet që do të realizohen nga projektligji janë:

- Përgjegjësit e Sekretarisë përfshirë mbledhjen dhe regjistrimin e rasteve bazuar në versionin origjinal të skanuar të dokumenteve kadastrale të para qershorit të vitit 1999 të cilat janë marrë në Kosovë nga autoritetet serbe e të pranuar nga/ përmes Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian;
- Krahasimi i tyre me dokumentet kadastrale në Kosovë për të i identifikuar zbraçetë apo mospërputhjet në mes të këtyre dy grupeve të dokumenteve;
- Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore është organi i pavarur kuazi-gjyqësor i mandatuar dhe lartësinë e kompensimit e cakton institucioni që e emëron
- Procedurat për njohje ligjore të të drejtave joformale pronësore parashtrihen në Sekretari brenda 3 vjetësh;
- Mjetet e ndara për zbatimin e skemës së kompensimit mbahen në llogari të mirëbesimit deri në zbatim të vendimeve;
- Procedurat e dëbimit dhe ridëbimit zbatohen nga AKKVP për aq herë sa uzurpohen;
- Formalizimin e të drejtave pronësore të pakontestueshme dhe legjitime të bartura në mënyrë joformale sipas Strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore;
- AKKVP do të vazhdoj me administrimin e pronave dhe zbatimin e skemës së qirasë deri në një aprovim të ri të propozuar nga Qeveria dhe mandatuar nga Kuvendi.

#### Përfundimi

Projektligji për plotësim ndryshimin e ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave nuk krijon kosto shtesë për buxhetin e Kosovës, sipas vlerësimeve shuma prej 10,208,586 euro për vitet 2020-2023 është kosto e cila është e ndarë në ligjin nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 si dhe në projeksionet buxhetore në KASH 2021-2023 për AKKVP-në si zbatuese e këtij projektligji.

Përgatitur nga:

*për* Atifcic Jakupaj, Analiste e buxhetit 

Konfirmon:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror 